



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7.9.2023

Nr:765

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOALICIONIT "BASHKË FITOJMË", (BF) "PËR REGJISTRIMIN SI
SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24
SHTATOR 2023**

Sot më datë, 7.9.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 6768 Prot., datë 6.9.2023, me:

Kërkues: "Partia e Lirisë" me kryetar z. Ilir Metaj.

Objekti: Regjistrimi i koalicionit "BASHKË FITOJMË", për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

Baza ligjore: Neni 65 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 28 datë 16.8.2023 "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023", ka caktuar datën 6.9.2023 si afatin e fundit për paraqitjen e kërkesës në KQZ, për regjistrimin si koalicion për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës.

Data: 7.9.2023 Nr: 765
Ora: 17:00



"Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit "BASHKË FITOJMË",(BF), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023."

Partia e Lirisë brënda afatit të përcaktuar ka paraqitur kërkesën me nr. 1141 prot., datë 6.9.2023 për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” është depozituar edhe marrëveshja, sipas të cilës rezulton se partitë pjesëmarrëse në koalicion do të jenë, “Partia e Lirisë”, “Partia Demokratiane e Shqipërisë” dhe “Partia Demokratike”.

Nga sa më sipër marrëveshja është e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në koalicion, ku rezulton se në emër të Partisë Demokratike ka nënshkruar z. Sali Berisha.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 745, datë 4.9.2023 ka vendosur regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike” si subjekt zgjedhor, por me kryetar z. Lulzim Basha.

Rezulton se “Partia Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha nuk ka shprehur vullnetin për të qënë pjesë e koalicionit “ Bashke Fitojmë”.

Marrëveshja e sipërcituar përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të dy partive pjesëmarrëse për të qënë pjesë e koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “BASHKË FITOJMË”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “BF”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Ilir Metaj, kryetar i partisë “Partia e Lirisë”/ ose të autorizuarin prej tij, të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe/ose KZAZ, kandidatët për kryetar bashkie në këtë njësi, si dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për rregjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve , deri në përfundim të procesit zgjedhor;
6. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Partia e Lirisë”;
7. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
8. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
9. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;
10. Numri i kandidatëve dhe renditja e tyre do të do bëhet sipas marrëveshjes midis palëve.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor.

1. Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
2. Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ketë shprehur vullnetin për të qënë pjesë e koalicionit.
3. Kushti i tretë është që numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion duhet të jetë dy ose më shumë se dy.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se, kërkesa për t'u regjistruar si koalicion, është e bazuar për partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. "Partia e Lirisë" me kryetar z. Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 747 datë 4.9.2023;
2. "Partia Demokristiane e Shqipërisë" me kryetar z. Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 762, datë 6.9.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Regjistrimin e Koalicionit "BASHKË FITOJMË", "BF", si subjekt zgjedhor pjesëmarrës për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:
 - a) "Partia e Lirisë" (PL);
 - b) "Partia Demokristiane e Shqipërisë" (PDK).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI